



Datë: 18.03.2025  
Numër Protokolli: 2594/2025

A.nr.195/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave**, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Ylber Fetahaj në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesën me numër A.nr.195/2025 të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesit N.N, D.H, E.T, A.K, A.A, V.D, B.G, Sh.H, R.S dhe A.H, te cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. Hajzer Salihu nga Prishtina , kundër organit të punësimit Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon procedimi administrativ** i filluar sipas ankesës me numër A.nr.195/2025 të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesit N.N, D.H, E.T, A.K, A.A, V.D, B.G, Sh.H, R.S dhe A.H.

## A r s y e t i m

N.N, D.H, E.T, A.K, A.A, V.D, B.G, Sh.H, R.S dhe A.H., te cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. Hajzer Salihu nga Prishtina (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*), kandidat për pranim në shërbimin civil në procedurën e pranimit sipas Konkursit me numër reference RN00014762 të shpallur më datë 07.08.2024, nga Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për “*Grupin e Administrimit të Përgjithshëm*”, gjegjësisht për pozitën “*Inspektor i Tokës Bujqësore*”, më datë 23.01.2025 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 24.12.2025, për anulimin e konkursit për pozitën Inspektor i Tokës Bujqësore me numër Reference RN00014762 të publikuar nga U.D Menaxheri i Personelit ne Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë..

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueseve ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, i filluara me ankesën e ankueseve, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë, më datë 07.08.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00014762, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita „Inspektor i Tokës Bujqësor”, Kategoria Profesional 1, dhjetë (10) pozita, ku afati për aplikim ka qenë nga data nga data 08.08.2024 deri më 06.09.2024.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezultojnë se në këtë konkurs kanë aplikuar 202 kandidat, ndërsa në listën e ngushtë si kandidat që kanë plotësuar kriteret janë përfshirë 144 kandidat, ne mesin e tyre edhe ankuesit, ku te njëjtë i janë nënshtruar fazës së testit me shkrim dhe intervistës me gojë. Divizioni i Burimeve Njerëzore i Agjencisë për Zhvillim të Bujqësisë, datë 22.10.2024 ka publikuar njoftimin për renditjen përfundimtare të kandidatëve fitues për pozitën „Inspektor i Tokës Bujqësor”, me dhjetë (10) kandidatë fitues: N.N me gjithsejtë 89.4 pikë, A.A me gjithsejtë 86.8 pikë, E.T me gjithsejtë 86.00 pikë, D.H me gjithsejtë 85.8 pikë, Sh.H me gjithsejtë 84.8 pikë, A.K me gjithsejtë 82.6 pikë, B.G me gjithsejtë 82.0 pikë, R.S me gjithsejtë 81.4 pikë, V.D me gjithsejtë 79.4 pikë dhe A.H me gjithsejtë 77.4 pikë.

Rrjedhimisht, sipas Njoftimit për renditjen përfundimtare të kandidatëve fitues, të datës 22.10.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë, rezultojnë se ankuesit e lartcekur janë shpallur kandidatë fitues për pozitën „Inspektor i Tokës Bujqësor”, mirëpo kundër këtij njoftimi më datë 15.11.2024 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kandidati për praninë në pozitën e njëjtë E.I, ndërsa Këshilli përmes Vendimit me numër A.nr.1734/2024 të datës 13.12.2024, pas shkeljeve ligjore të konstatuara në këtë procedurë rekrutimi, kishte aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit, dhe si për rrjedhojë kishte anuluar konkursin e sipër theksuar. Andaj në zbatim të Vendimit të Këshillit, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë, përmes Njoftimit të datës 24.12.2024, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00014762, për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësore” në Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendojnë se anulimi i konkursit është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe kundër bazës ligjore të aplikuar në shpalljen e konkursit dhe te njëjtë kërkojnë që të aprovohet ankesa e ankuesve, të shfuqizohet Vendimi me numër A.nr.1734/2024 të datës 13.12.2024 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të anulohet Njoftimi i datës 24.12.2025, për anulimin e konkursit për pozitën Inspektor i Tokës Bujqësore me numër Ref. RN00014762 i publikuar nga U.D Menaxheri i Personelit në Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë, ndërsa Njoftimi për renditjen përfundimtare të kandidatëve fitues, i datës 22.10.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë të mbetet në fuqi dhe ankuesve t’ua lëshohen akt emërimet.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesve të parashtruar si në ankesë, thekson faktin se Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1734/2024 të datës 13.12.2024, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference RN00014762 për “Grupin e Administrimit të Përgjithshëm”, gjegjësisht për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësor, në kuadër të Agjencisë për Zhvillim të Bujqësisë.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.1734/2024 të datës 13.12.2024, është anuluar Konkursi me numër reference RN00014762, për pozitën “*Inspektor i Tokës Bujqësor* në Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”**, ngase akti i kontestuar me ankesën e datës 23.01.2025, nga ankuesit është nxjerrë vetëm në zbatim të Vendimit të sipër theksuar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe si i tillë është bërë i pamundur shqyrtimi i kësaj ankese.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.195/2025, të datës 23.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.195/2025**

**Ylber FETAHAJ**

\_\_\_\_\_  
Procesmbajtës

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

\_\_\_\_\_  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar Av. Hajzer Salihu;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.